



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT**

**VENDIM**

Nr. **19** datë 17.06.2020

**MBI**

**“MIRATIM PËR PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË  
STUDENTËT TË CIKLIT TË PARË, PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020, NË  
UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, date 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar); urdhrin e Rektorit të Universitetit të Arteve nr. 77, datë 07.11.2019 ”Mbi përcaktimin e kriteve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studenët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë, në Universitetin e Arteve”, Bordi i Administrimit pasi diskutoi rreth Relacioneve të paraqitura nga Fakulteti i Muzikës dhe Fakulteti i Artit Skenik, nëpërmjet Administratores së UART Znj. Alma Sinanaj dhe duke u bazuar në aktet e dala për këtë qëllim, pasi e diskutoi,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, të studentëve të Fakulteteve të Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2019-2020, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur vendimit.
2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë dhe Agjencisë Kombëtare së Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakultetet e Universitetit të Arteve dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**



